



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.174/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së njoftimeve për mbajtjen e tubimit publik në shtyll elektrike në komunën e Prishtinë, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohen** si të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,600.00 (dymijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat ZL. Anr. 174/2017, dhe ZL. Anr. 175/2017 të datës 11.10.2017 dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL. Anr. 174/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të dy ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 10.10.2017 në rrugën Pjetër Bogdani dhe në rrugën Mark Isaku në Prishtinë kanë hasur të vendosur në shtyll elektrike njoftime për mbajtjen e tubimit publik të subjektit politik LDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës 13/2014, si dhe nenit 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastet në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 11.10.2017, subjekti politik LDK, e konsideron si të pabazuar dhe të paarsyeshme ankesën për faktin se nuk mund të konsiderohet shkelje e dispozitave ligjore njoftimi mbi tubimin elektorale që ka karakter të përkohshëm mbi zhvillimin e një ngjarje apo tubimi dhe se vendosja e këtyre njoftimeve është e përkohshme dhe nuk përbën

shkelje. Përkundër kësaj subjekti politik LDK ka kërkuar nga dega e saj në Prishtinë që të ndërmar të gjitha masat dhe ta evitoj shkeljen e supozuar me ankesë. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se janë larguar njoftimet nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesat vlerësoi se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se njoftimet për mbajtjen e tubimit publik të subjektit politik LDK janë vendosur në shtylla elektrike gjegjësisht në objekte publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve dhe slloganeve, në objekte publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që njoftimet për mbajtjen e tubimit publik në komunën e Prishtinës nga ky subjekt politik, janë vendosur në objekte publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik LDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti njoftimet për mbajtjen e tubimit të subjektit politik nga subjekti politik LDK janë vendosur në shtylla elektrike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr njoftimet në fjalë nga vendet e palejuara ku ka qenë të vendosur ato.

Paneli gjat vendosjes mori parasysh edhe faktin se subjekti politik LDK ka bërë perpjekje serioze të përcaktuar me nenin 32 par.6 pikat a), b), c), d),e) të LZP-së, për ti parandaluar parregullësit që po shkaktohen nga simpatizantet apo mbeshtetësit e subjektit në fjalë, dhe ky

veprim i subjekti në fjal nga paneli është vlerësuar pozitivisht dhe ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL. Anr.174/2017 më datën 12.10.2017.



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*